



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 50, datë 30.03.2011

**PËR
LICENCIMIN E KUSHTËZUAR TË “SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE
TË PENSIONIT SIGAL-LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA” SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe nenit 26 dhe 27 të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në bazë dhe për zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” neni 108, institutet ekzistuese të pensioneve, të krijuara në përputhje me Ligjin nr. 7943, datë 01.06.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”, duhet të paraqesin kërkesën për licencë brenda një viti nga hyrja në fuqi e ligjit.

Në zbatim të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, shoqëria “Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Capital IPP” sh.a, depozitoi në AMF, statutin e shoqërisë administruese, emrin e ri ligjor, anëtarët e Këshillit Administrativ, si dhe të gjithë dokumentacionin për licencim.

Në zbatim të nenit 24, të Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009:

- Shoqëria është themeluar si shoqëri aksionare, e cila zotërohet në masën 51% nga shoqëria “Sigal-Life Uniqa Group Austria” sh.a.
- Shoqëria është e organizuar sipas sistemit me një nivel. Këshilli i Administrimit përbëhet nga 6 anëtarë me mandat 3 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Këshilli emëron 1 person si administrator dhe përfaqësues të shoqërisë. Administratori është njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit të Administrimit.
- Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 35.000.400 lekë, i ndarë në 29.167 aksione të zakonshme me vlerë nominale 1.200 lekë.

- Emri i propozuar është “Shoqëria administruese e fondeve të pensionit Sigal-Life Uniq Group Austria” sh.a.
- Objekti i veprimtarisë është përcaktuar: “Mbledhja dhe investimi i fondeve të pensioneve në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009, si dhe në përputhje me parimin e diversifikimit të riskut, me qëllim ofrimin e përfitimeve të pensionit për personat që anëtarësohen në fondin e pensionit. Shoqëria mund të ketë edhe funksionin e kryerjes së pagesave të pensionit”.
- Administratorët e shoqërisë.

Në përbërje të Këshillit të Administrimit marrin pjesë përfaqësues me formim të lartë profesional dhe eksperiencë në administrimin e shoqërisë Uniq Group Austria. Administratori i “Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit Sigal-Life Uniq Group Austria” sh.a, ka një eksperiencë të gjatë pune drejtuese dhe aftësi profesionale në tregun e pensioneve. Krahas njohurive profesionale të përmendura më sipër administratori i shoqërisë duhet të plotësojë aftësitë profesionale me kualifikime shtesë për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar.

Për sa më sipër, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e “Shoqërisë administruese të fondeve të pensionit Sigal-Life Uniq Group Austria” sh.a për të vepruar si shoqëri e administrimit të fondeve të pensionit vullnetar, për mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensioneve, si dhe kryerjen e pagesave të pensionit, me kusht që:
 - a) Administratori i shoqërisë administruese të plotësojë aftësitë profesionale me kualifikime shtesë për administrimin e fondeve të pensionit vullnetar brenda 3 vjetësh.
 - b) Këshilli i administrimit gjatë periudhës së përcaktuar më sipër të ushtrojë disa nga kompetencat e administratorit lidhur me administrimin e aseteve të fondeve.
 - c) Shoqëria të paraqesë menjëherë pranë AMF-së një plan të detajuar të masave për plotësimin kushteve të mësipërme.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI